



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 293/10 prot.

Datë 03.03.2026

V E N D I M

Nr. 336/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.03.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 260/2026, datë 16.02.2026 për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-74198-01-20-2026, me objekt: “Shërbim mirëmbajtje i platformës së integruar dhe të shkallëzueshme të sistemit të dixhitalizimit në Spitalin Rajonal Memorial Fier”, me fond limit 30,000,000 (Tridhjetë milion) lekë, pa TVSH, ose 310,784.21 (Treqind e dhjetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e katër pik njëzet e një) Euro **pa TVSH**, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 20-02-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK me NIPT K21710002J dhe adresë Rruga "Murat Toptani", Godina Eurocol, Kati 8, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve të Përqendruara me adresë Rr. “Reshit Çollaku”, godina nr.6/337 (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 16.02.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 260/2026, ku vendosi: [...]

- 1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-74198-01-20-2026, me objekt: “Shërbim mirëmbajtje i platformës së integruar dhe të shkallëzueshme të sistemit të dixhitalizimit në Spitalin Rajonal Memorial Fier”, me fond limit 30,000,000 (Tridhjetë milion) lekë, pa TVSH, ose 310,784.21 (Treqind e dhjetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e katër pik njëzet e një) Euro **pa TVSH**, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 20-02-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.*
- 2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK për procedurën e prokurimit të mësipërme.*
- 3. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës dhe Komisionit të Prokurimit Publik.*
- 4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
- 5. Ngarkohet zyra e financës, që të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK.*
- 6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
- 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën me nr. 283/11 prot., datë 23.02.2026 me lëndë “Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 260/2026 me nr. 293/5 Prot., datë 16.02.2026”, protokolluar me tonën me nr. 293/7 prot., datë 26.02.2026 autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara njofton se ka zbatuar vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr. 260/2026, datë 16.02.2026 për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-74198-01-20-2026, me objekt: “Shërbim mirëmbajtje i platformës së integruar dhe të shkallëzueshme të sistemit të dixhitalizimit në Spitalin Rajonal Memorial Fier”, me fond limit 30,000,000 (Tridhjetë milion) lekë, pa TVSH, ose 310,784.21 (Treqind e dhjetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e katër pik njëzet e një) Euro pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 20-02-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara. Bashkëlidhur autoriteti kontraktor ka dorëzuar Njoftimin për ndryshimin e dokumentave të tenderit me nr. 283/10 prot., datë 23.02.2026.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën me nr. 283/11 prot., datë 23.02.2026 me lëndë “Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 260/2026 me nr. 293/5 Prot., datë 16.02.2026”, protokolluar me tonën me nr. 293/7 prot., datë 26.02.2026 autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara njofton se ka zbatuar vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr. 260/2026, datë 16.02.2026 për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-74198-01-20-2026, me objekt: “Shërbim mirëmbajtje i platformës së integruar dhe të shkallëzueshme të sistemit të dixhitalizimit në Spitalin Rajonal Memorial Fier”, me fond limit 30,000,000 (Tridhjetë milion) lekë, pa TVSH, ose 310,784.21 (Treqind e dhjetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e katër pik njëzet e një) Euro pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 20-02-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Referuar shkresës me nr. 283/11 prot., datë 23.02.2026, si dhe nga verifikimi i kryer në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE), Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor ka publikuar shtojcën për modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit në përputhje me vendimin me nr. 260/2026, datë 16.02.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, në mënyrë që të bëhet e njohur për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar.

II.3. Sa më sipër arsyetuar autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 260/2026, datë 16.02.2026.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-74198-01-20-2026, me objekt: “Shërbim mirëmbajtje i platformës së integruar dhe të shkallëzueshme të sistemit të dixhitalizimit në Spitalin Rajonal Memorial Fier”, me fond limit 30,000,000 (Tridhjetë milion) lekë, pa TVSH, ose 310,784.21 (Treqind e dhjetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e katër pik njëzet e një) Euro pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 20-02-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

